



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10

Prishtinë

10000

Republika e Kosovës

T/F: +381 38 746 206

E-mail: ridea.institute@gmail.com

**ANALIZË MBI PËRFSHIRJEN MË TË MIRË TË QYTETARËVE DHE
ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN E
INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROCESIN E ZBATIMIT TË
MARRËVESHJES PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM**

Prishtinë, Shtator 2016

Përmbajtja

1. Përmbajtja, qëllimet dhe metodologjia e projektit	3
1.1. Rëndësia dhe qëllimet e projektit	3
1.2. Metodologjia	5
1.3 Pyetësi	5
2. Bashkëpunimi i Organizatave të Shoqërisë civile dhe Akterëve Institucional në Procesin e Integrimit në BE dhe Procesin e Zbatimit të MSA-së	6
2.1 Organizatat e Shoqërisë Civile në Kosovë	6
2.2 Dokumentet Kryesore për Rregullimin e Bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe OSHC-ve	9
2.3 Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile në Procesin e Integrimit në BE	10
2.4 Mekanizmat e Bashkëpunimit ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Akterëve Qeveritarë	13
2.5 Cilësia e Bashkëpunimit ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Kombëtare në Kosovë	16
3. Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile në Proceset e Integrimit Evropian në Ballkanin Perëndimor: Mësimet nga Kroacia	21
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet	25
4.1. Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës	27
4.2. Rekomandimet për Organizatat e Shoqërisë Civile	29
5. Shtojca	31

Ky hulumtim është bërë i mundur me kontributin e projektit "MSA dhe ngritja e vetëdijes publike rreth liberalizimit të vizave", i financuar bashkërisht nga Ministria e Integrimit Evropian dhe UNDP Kosovë.

Të gjeturat dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin qëndrimet zyrtare të të dyja organizatave.

1. Përmbajtja, qëllimet dhe metodologjia e projektit

1.1. Rëndësia dhe qëllimet e projektit

Kosova është kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Të dy palët kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (në vijim: MSA) më 27 tetor 2015 në Strasburg, e cila ka hyrë në fuqi nga 1 prill 2016. MSA ofron një kornizë për marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe BE-së, dhe ka për qëllim zbatimin e agjendës së reformave Evropiane për Kosovën - që synon që në mënyrë progresive të përafroj Kosovën me BE-në në të gjitha fushat e politik-bërjes, deri në marrjen e anëtarësimit të plotë në BE. Prandaj, për të përmbushur këtë pritje Kosova duhet të ndërmerret reforma politike dhe ekonomike dhe të miratojë legjislacionin e BE-së - në mënyrë specifike të miratojë të gjitha traktatet dhe ligjet të cilat janë në fuqi në të gjitha vendet anëtare të BE-së. Procesi i reformës monitorohet tërësisht direkt nga institucionet e BE-së dhe të gjitha vendet-anëtare të BE-së.

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së thekson nevojën për të bërë përdorim optimal të kapaciteteve kombëtare për një përgatitje afatgjate dhe një qasje gjithëpërfshirëse nga pjesë të ndryshme të shoqërisë në mënyrë që të zbatohet MSA.¹ Programi gjithashtu vë në dukje se duke përgjatë rrugës së integrimit në BE, përfshihet edhe rritja e kapaciteteve institucionale dhe gatishmëria për një reformë të thellë politike dhe ekonomike, të cilat në fund do të ndikojnë në sferat e ndryshme të jetës në shoqërinë e Kosovës. Në këtë drejtim, angazhimi i organizatave të shoqërisë civile (në vijim: OSHC) në procesin e integrimit sigurisht që mund të përforcoj punën e Qeverisë, përfaqësoj grupe të ndryshme të qytetarëve dhe si pasojë do të forcoj demokracinë. Prandaj, në mënyrë që të kemi një përfshirje të konsiderueshme të të gjithë akterëve, një rol më aktiv duhet t'i jepet OSHC-ve, me mjetet për të kontribuar, promovuar dhe monitoruar zbatimin e MSA-së.

¹ Qeveria e Kosovës (2016) *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim*. E disponueshme: http://www.mei-ks.net/repository/docs/3_pkzmsa_miratuar nga_kuvendi_final_eng_.pdf (vizituar më: 13/09/2016).

Në fakt, një nga kushtet e vendosura për progresin në procesin e anëtarësimit në BE, është rritja e bashkëpunimit mes Qeverisë së Kosovës dhe OSHC-ve. Në këtë aspekt, Raporti i Komisionit Evropian për Progresin në Kosovën (2015) vë në dukje se edhe pse ka pasur përmirësime në bashkëpunimin mes Qeverisë dhe OSHC-ve, strategjia qeveritare për bashkëpunim me OSHC-të nuk është zbatuar plotësisht.² Për më tepër, BE-ja e njeh rolin e OSHC-ve si një element kyç i një sistemi demokratik, dhe rekomandon që si e tillë ajo duhet të mbajë një rol aktiv në procesin e integrimit. Përfshirja e OSHC-ve në përmirësimin dhe monitorimin e procesit të krijimit të politikave; mund të ndihmojë të bëhen reformat e duhura, pra të ndihmojë në aspiratat e Kosovës për t'u bashkuar me BE-në. Si pasojë, është e një rëndësie jetike për të hetuar mënyrat e rritjes së cilësisë së pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e integrimit në BE dhe në procesin e zbatimit të MSA-së.

Ky raport shqyrton një dimension të procesit të integrimit të Kosovës në BE - dimensionin e OSHC-ve. Objektivi kryesor është për të hetuar dhe për të analizuar se si OSHC-të janë integruar në procesin e integrimit në BE, në lidhje me bërjen e politikave, monitorimin e procesit të qeverisjes dhe ngritjen e vetëdijes publike për procesin e integrimit në BE. Për më tepër, ky raport do të adresojë këto çështje: Cilat janë pozicionet qëndrore të organeve shtetërore dhe përfaqësuesve të OSHC-ve në atë se si dhe ku ky i fundit duhet të marrë pjesë në proceset e integrimit dhe cilat janë aspektet problematike? Si mund të mobilizohen OSHC-të dhe qytetarët për të ndihmuar në procesin e integrimit?

Raporti ofron një pasqyrë të plotë të mekanizmave të përdorur për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe OSHC-ve në procesin e integrimit në BE. Gjithashtu raporti trajton praktikat më të mira dhe sfidat për një bashkëpunim të tillë, dhe jep rekomandime për tejkalimin e sfidave.

² Komisioni Evropian (2015) *Raporti 2015 për Kosovën*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf (vizituar më: 13/09/2016).

1.2. Metodologjia

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të ofrojë një analizë të thellë mbi atë se si të përfshihen më mirë qytetarët dhe OSHC-të në procesin e integritit në BE dhe në procesin e zbatimit të MSA-së. Për të arritur këtë qëllim, ne kemi përdorur dy mjete kryesore të hulumtimit:

Së pari, kemi bërë intervista me përfaqësues të OSHC-ve, komunitetin akademik dhe me zyrtar institucional. Kështu, institucionet e mëposhtme përfaqësojnë ndër të tjera, disa nga akterët relevant kryesorë të cilët janë konsultuar dhe/ose janë intervistuar për këtë studim:

- 1) CiviKos
- 2) Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
- 3) D4D
- 4) Grupi Ballkanik për Politika dhe Hulumtime
- 5) Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
- 6) KIPRED
- 7) Levizja FOL
- 8) Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
- 9) Parlamenti i Kosovës, Komisioni për Integritim Evropian
- 10) Ministria e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës
- 11) Ministria për Integritim Evropian, Republika e Kosovës.

Së dyti, kemi grumbulluar dhe shqyrtuar të dhënat nga raportet e projekteve të organizatave ndërkombëtare (të tilla si raporti vjetor i progresit nga Komisioni Evropian) dhe/ose raportet apo strategjitë e institucioneve përkatëse kombëtare (të tilla si raportet nga Ministria për Integritim Evropian e Kosovës).

1.3 Pyetësori

Me qëllim të zbatimit të hapit të parë dhe më të rëndësishëm metodologjik të projektit - intervista - u bë e nevojshme për të formuluar një seri pyetjesh të veçanta, të cilat do të

ndihmonin për të kryer studimin. Prandaj, në mënyrë që të jetë në gjendje për të mbledhur informacionet e nevojshme dhe për të arritur qëllimet e studimit, RIDEA ka hartuar një pyetësor me 15 pyetje. Teksti i plotë i pyetësorit është bashkëngjitur në formën e një shtojce në këtë raport.

2. Bashkëpunimi i Organizatave të Shoqërisë civile dhe Akterëve Institucional në Procesin e Integritit në BE dhe Procesin e Zbatimit të MSA-së

2.1 Organizatat e Shoqërisë Civile në Kosovë

Shoqëria civile është konsideruar si një komponent i rëndësishëm i një shoqërie demokratike. Koncepti i shoqërisë civile varet nga konteksti kulturor, politik dhe administrativ i një vendi. Sipas Scholte (1999), shoqëria civile mund të kuptohet si një hapësirë politike ku shoqatat vullnetare qëllimisht kërkojnë të u japin formë rregullave që drejtojnë aspektet e jetës shoqërore.³ CIVICUS, një rrjet global i OSHC-ve, përcakton shoqërinë civile si "arena, jashtë familjes, shtetit dhe tregut, e cila është krijuar nga veprimet individuale dhe kolektive, organizatat dhe institucionet për të çuar përpara interesat e përbashkëta (p. 10)."⁴

Në aspekt organizativ, shoqëria civile përfshin grupet e regjistruara në mënyrë formale dhe të themeluara zyrtarisht, si dhe shoqata që mund të mos shfaqen të regjistruara zyrtarisht.⁵ Sipas Komisionit Evropian për Komunitete (2002), OSHC mund të përdoret si një shkurtesë për një sërë organizatash, si: organizata që përfaqësojnë aktorët social dhe ekonomik, lojtarët e tregut të punës (p.sh., sindikatat), organizatat jo-qeveritare (p.sh., organizata të të

³ Scholte, A. J. (1999) *Shoqëria Civile Globale: Të ndryshojmë botën?* Punim CSGR Nr. 31/99. E disponueshme: http://www.unicef.org/socialpolicy/files/Global_Civil_Society_Changing_the_World.pdf (vizituar më 13/09/2016).

⁴ CIVICUS (2013) *Gjendja e Shoqërisë Civile 2013: Krijimi i një Ambienti Optimal*. E disponueshme: http://socs.civicus.org/wp-content/uploads/2013/04/2013StateofCivilSocietyReport_full.pdf (vizituar më 13/09/2016).

⁵ *Udhëzimet për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet në zhvillim 2014-2020*. E disponueshme: https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/elarg_guidelines_cs_support_after_online_consultation_03072013.pdf (vizituar më 13/09/2016).

drejtave të njeriut, organizatat bamirëse), organizatat me bazë komunitare (p.sh., shoqatat rinore, shoqatat familjare) dhe komunitetet fetare.⁶

Gjurmët e OSHC-ve të para në Kosovë mund të gjenden rreth viteve 1980-ta dhe në fillim të viteve 1990. Gjatë viteve 1990 OSHC-të kanë ofruar shërbime të kufizuara në fushën e kujdesit shëndetësor dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Megjithatë, numri i OSHC-ve është rritur në mënyrë të konsiderueshme pas luftës, duke mbuluar fusha të shumta, të tilla si demokracia, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut, çështjet e minoriteteve dhe zhvillimin e komunitetit, etj. Edhe pse, ka rreth 7000 OSHC të regjistruara në Kosovë, vetëm një pjesë e vogël e tyre janë aktive ose pjesërisht aktive.⁷

Pas luftës, për shkak të shkallës të madhe të mbështetjes financiare dhe teknike nga donatorët ndërkombëtarë, shumica e OSHC-ve përcaktojnë qëllimet dhe aktivitetet e tyre në bazë të prioriteteve të donatorëve. Si rezultat i kësaj, OSHC-të në Kosovë kanë qenë jo konsistente në respektimin e misionit të tyre të caktuar dhe më pak të përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit.⁸ Megjithatë, një numër i OSHC-ve kanë lëvizur vazhdimisht përpara në formësimin dhe profilizimin e tyre. Disa nisma dhe fushata të suksesshme kanë ndikuar në zhvillimet e politikave, dhe kështu kanë luajtur një rol vendimtar në pozicionimin e shoqërisë civile si një sektor i rëndësishëm në procesin e shtet-ndërtimit dhe të demokratizimit.

Raporti i indeksit të shoqërisë civile Kosovare në vitin 2014 përshkruan gjendjen e OSHC-ve në Kosovë, sa i përket strukturës, kuadrit ligjor, financimit, ndikimin e perceptuar të OSHC-

⁶ Komisioni Evropian për Komunitete (2002) *Komunikatë nga Komisioni*. E disponueshme: http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2002:0704:FIN:EN:PDF#_Toc46744741 (vizituar më 13/09/2016).

⁷ Hoxha, T. (2011) *Qeverisje më të mirë për Ndikim më të madh: Thirrje për Qytetarët*. E disponueshme: <http://civicus.org/downloads/CSI/Kosovo.pdf> (vizituar më 13/09/2016).

⁸ Nilsson, S. (2012) *Opinion i Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian – Roli i shoqërisë civile në raportet BE - Kosovë*. E disponueshme: http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.C_.2012.181.01.0021.01.ENG#ntr7-C_2012181EN.01002101-E0007 (vizituar më 13/09/2016).

ve dhe mjedisin e jashtëm në të cilën operojnë OSHC-të.⁹ Gjetjet kryesore të këtij studimi janë përmbledhur më poshtë:

- ❖ Në përgjithësi, OSHC-të që janë të angazhuara në hartimin e politikave perceptojnë ndikimin e tyre si të kufizuar. Dhe në mënyrë të veçantë, OSHC-të perceptojnë që kanë ndikim të kufizuar në çështjet që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit, por që kanë më shumë ndikim në fushën e demokratizimit, barazisë gjinore dhe në mbështetje të komuniteteve të varfura dhe grupeve të marginalizuara;
- ❖ Qasja e OSHC-ve në informata publike dhe përfshirja e tyre në proceset konsultative për zhvillimin e ligjeve dhe politikave është vlerësuar si e kufizuar. Problemi thellohet edhe nga mungesa e zbatimit të sanksioneve të parapara ligjore për zyrtarët që refuzojnë qasjen në informata zyrtare;
- ❖ OSHC-të mbeten shumë të varura nga fondet ndërkombëtare. Rreth 74% e fondeve vijnë nga donatorët ndërkombëtarë. Si pasojë, donatorët mund të ndikojnë në agjendën e shoqërisë civile;
- ❖ Anëtarësimi i qytetarëve në OSHC mbetet shumë i ulët, ku vetëm 2% të popullsisë janë pjesë e një ose më shumë OSHC-ve.

Studime tjera tregojnë se *një në pesë* Kosovar marrin pjesë në ndonjë mënyrë në aktivitetet e OSHC-ve¹⁰ dhe se qytetarët vendosin shkallë relativisht të lartë të besimit në punën e tyre në Kosovë; më e rëndësishmja shkallë më të lartë të besimit se në punën e Qeverisë.¹¹ Për më tepër, në vitet e fundit janë vërejtur disa përmirësime të vogla në qëndrueshmërinë e përgjithshme të OSHC-ve, duke pasur parasysh rritjen e fondeve nga institucionet qendrore

⁹ Hoxha, T. (2014) *Indeksi i Shoqërisë Civile Kosovare*. E disponueshme: http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/05_02_2015_2315218_KCSF_Kosovar_Civil_Society_Index_web_final_ENG.pdf (vizituar më 13/09/2016).

¹⁰ Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (2008) *Raporti i Kosovës për Zhvillim Njerëzor*. E disponueshme at: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/human_development/KHDR2008.html (vizituar më: 13/09/2016).

¹¹ Instituti Ndërkombëtar Suedez për administratë publike (2014) *Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë*. E disponueshme: http://www.tacso.org/doc/ipsos_report_ko.pdf (vizituar më 13/09/2016).

dhe lokale për ofrimin e shërbimeve, dhe forcimin e bashkëpunimit formal në mes të OSHC-ve dhe hartuesve të politikave.¹²

2.2 Dokumentet Kryesore për Rregullimin e Bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe OSHC-ve

Kosova ka hartuar tri dokumente të rëndësishme që drejtojnë bashkëpunimin në mes të Qeverisë dhe OSHC-ve. Këto dokumente janë diskutuar shkurtimisht më poshtë:

- i. Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2007 e ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit të Qeverisë së Kosovës me Shoqërinë Civile përfaqësuar nga Platforma CiviKos.¹³ Përmes këtij memorandumi të bashkëpunimit, Qeveria dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile ranë dakord mbi parimet kryesore të bashkëpunimit. Memorandumi është vlerësuar si një hap i parë i domosdoshëm për të vendosur bazat për zhvillimin e një Strategjie Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.
- ii. Qeveria e Kosovës në gusht të vitit 2013 ka miratuar Strategjinë e Qeverisë dhe Planin e Veprimit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017.¹⁴ Në përgjithësi, kjo strategji synon të sigurojë një mjedis mbështetës dhe të favorshëm për zhvillimin e OSHC-ve dhe të krijojë mekanizma të strukturuar për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe Qeverisë së Kosovës. Në mënyrë të veçantë, ajo ka për qëllim të nxisë pjesëmarrjen e OSHC-ve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacioneve, kontraktimin e shërbimeve publike për OSHC-të, zhvillimin e

¹² Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (2014) *Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2014 për Evropën Qëndrore dhe Lindore dhe Euroazinë*. E disponueshme:

https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/EuropeEurasia_FY2014_CSOSI_Report.pdf (vizituar më 13/09/2016).

¹³ Për raportin e plotë, vizitoni: <https://zgm.rks.gov.net/Portals/0/Memorandumi%20i%20bashkepunimit%20Anglisht%20%20.pdf> (vizituar më 13/09/2016).

¹⁴ Republika e Kosovës (2013) *Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile*. E disponueshme: [http://www.kryeministri.ks.net/repository/docs/Strategjia_qeveritare_per_bashkepunim_me_shoqerine_civile_drafti_perfundimtar_\(2\).pdf](http://www.kryeministri.ks.net/repository/docs/Strategjia_qeveritare_per_bashkepunim_me_shoqerine_civile_drafti_perfundimtar_(2).pdf) (vizituar më 13/09/2016).

kritereve të përcaktuara mirë për të mbështetur financiarisht OSHC-të dhe të nxisë një qasje të integruar ndaj zhvillimit të vullnetarizmit.

- iii. E fundit por jo më pak e rëndësishme, në mars të vitit 2016 Qeveria e Kosovës ka publikuar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes të Stabilizim Asocimit (PKZMSA).¹⁵ PKZMSA është dokumenti kryesor i politikave kombëtare për anëtarësim në BE, dhe si i tillë ofron kornizë për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për përmbushjen e marrëveshjes së MSA-së. PKZMSA pranon progresin e Kuvendit për sa i përket konsultimit me shoqërinë civile, duke treguar rritjen e numrit të konsultimeve me shoqërinë civile dhe me publikun. Megjithatë, ajo gjithashtu vë në dukje se është e nevojshme:

për të finalizuar standardet minimale për konsultim publik, së bashku me platformën "online" për shoqërinë civile për të mundësuar reagimin e hershëm të publikut mbi legjislacionin, politikat dhe strategjitë dhe për të rritur transparencën në kontekstin e përgjegjshmërisë si një parim themelor për administratën publike (po aty, f. 28).

Më tej, PKZMSA avokon përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile (p.sh., nëpërmjet anëtarësimit në këshilla të ndryshme) në trajtimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me axhendën e reformave për Kosovën, në një sërë fushash të tilla si korrupsioni, krimi i organizuar apo barazia gjinore.

2.3 Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile në Procesin e Integritimit në BE

Ka shumë faktorë ndikues që përcaktojnë procesin e konsolidimit demokratik të një vendi. Në përgjithësi, studiuesit bien dakord që konsolidimi i demokracisë nuk është i mundur pa një shoqëri civile dhe parti të institucionalizuara të forta dhe të pavarura - si dy aktorë vital

¹⁵ Shih fusnotën 1.

të demokracive të shëndetshme dhe funksionale.¹⁶ Në vendet me demokraci funksionale, OSHC-të janë supozuar të jenë një forum i madh politik për artikulumin e agjendave sociale dhe promovimin e të drejtave të njeriut.¹⁷ Në të kundërtën, kur OSHC-të përfaqësojnë vetëm nëngrupe të njerëzve, ata mund të kontribuojnë në fragmentim dhe polarizim të shoqërisë.¹⁸ Një OSHC e pavarur mund të komunikoj interesat e shoqërisë dhe të ndikoj në procesin e vendim-marrjes të Qeverisë. Në fakt, vazhdimisht është raportuar se niveli i anëtarësisë së organizatave është dukshëm më i lartë në vendet me demokraci të zhvilluar në krahasim me vendet e Evropës post-komuniste.¹⁹ Niveli i lartë i anëtarësisë organizative siguron zhvillimin demokratik të shtetit, pasi pjesëmarrja aktive e qytetarëve paraqet një tipar kritik të cilësisë së demokracisë.²⁰

Disa studime kanë shqyrtuar dhe vlerësuar rolin e OSHC-ve në procesin e integritimit në BE. Në këtë drejtim, Bogdan (2011) sugjeroi shtatë parakushte që mund të lehtësojnë angazhimin e suksesshëm në mes të OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë:²¹

(1) Përfaqësim më i centralizuar i shoqërisë civile. Kjo sugjeron rëndësinë e krijimit të rrjeteve të OSHC-ve me qëllime të përbashkëta, duke pasur parasysh se Qeveria do të ketë një platformë të vetme për të adresuar OSHC-të. Për më tepër, kjo do të forconte përpjekjet kolektive të avokimit të OSHC-së;

(2) Një kulturë e fortë e bashkëpunimit nga të dy anët. Kjo sugjeron se OSHC-të duhet të janë të përgatitura mirë për të ofruar kontributin e tyre në bërjen e politikave. Nga ana tjetër, Qeveria duhet të jetë e gatshme për të bashkëpunuar;

(3) Theksi mbi funksionin dhe jo në formën e angazhimit. Kjo sugjeron se fokusi duhet të jetë në cilësinë e bashkëpunimit, në vend të strukturës së bashkëpunimit;

¹⁶ Özler, I. dhe Sarkissian, A. (2011) Rruga pa kthim dhe Stagnimi në Demokratizimin e Turqisë: Roli i Shoqërisë Civile dhe Partive Politike. *Revista e Shoqërisë Civile*, Vëll. 7 Nr. 4, ff. 363-384.

¹⁷ Scott, J. dhe Liikanen, I. (2010) Shoqëria Civile dhe Evropianizimi "Fqinjësorë" nëpërmjet Bashkëpunimit Ndër-Kufitarë? *Revista e Integritimit Evropian*, Vëll. 32 Nr. 5, ff. 423-438.

¹⁸ Ekiert, G. dhe Busse, A. (2007) Forcimi i Pluralizmit dhe Pjesëmarrjes Publike në Demokraci të Reja. Në: J. I. Dominguez & A. Jones (Eds) *Ndërtimi i Demokracisë: Mësimet nga Praktika dhe Kërkimi*, ff. 20-44. Baltimor, MD: Johns Hopkins University Press.

¹⁹ Howard, M. M. (2003) *Dobësia e Shoqërisë Civile në Evropën Pas-Komuniste*. Cambridge: Cambridge University Press.

²⁰ Shih fusnotën 6.

²¹ Bogdan, B. N. (2011) *Roli i Shoqërisë Civile në Politikën Migruese të BE-së: Perspektiva mbi angazhimin e Bashkimit Evropian në fqinjët e saj*. Instituti Politikë për Migrim: Washington, DC.

(4) Angazhim i vazhdueshëm (në vend të një-herë). Për të krijuar një ndjenjë të pronësisë dhe qëndrueshmërisë, OSHC-të duhet të angazhohen në çdo fazë të procesit të anëtarësimit në BE;

(5) Prani të një shoqërie civile të fortë. Kjo sugjeron se OSHC-të duhet të dinë se çfarë funksionon më mirë në komunitetet e tyre dhe të mund të çojnë punën përpara kur fondet mbarojnë;

(6) Përfitim nga vrulli ekzistues për reforma. Institucionet e BE-së duhet të përdorin momentim e volitshëm për të angazhuar OSHC-të, me qëllim për të shfrytëzuar entuziazmin për reforma;

(7) Ndërtimi i kapaciteteve të reja. OSHC-të duhet të marrin mbështetje jo vetëm me para, por edhe nëpërmjet përdorimit kreativ të teknologjisë së re.

Më konkretisht, roli i OSHC-ve në procesin e integritimit në BE vlerësohet në përgjithësi nga ndikimi i saj në procesin e negociatave. Megjithatë, pasi që Kosova nuk ka filluar negociatat me BE-në, roli i OSHC-ve është theksuar në procesin e bërjes së politikave, monitorimin dhe miratimin e reformave të BE-së.²² OSHC-të përmes proceseve konsultative mund të japin kontribut në hartimin e strategjive, legjislacionit apo politikave dhe monitorimin e zbatimit të MSA-së. OSHC-të me anë të fushatave të ndryshme mund të rrisin vetëdijen e qytetarëve për MSA-në, njohuritë e të cilëve në këtë moment janë vlerësuar si të pakta.²³

Aktualisht, Kosova ballafaqohet me një numër sfidash drejt procesit të integritimit në BE, duke filluar nga mungesa e transparencës nga ana e aktorëve qeveritarë, mungesa e gjyqësorit të pavarur dhe ndërhyrjes politike në procesin gjyqësor, korrupsioni dhe ekonomia e dobët, etj. Në këtë drejtim, OSHC-të mund të ndihmojnë për të trajtuar disa nga këto çështje, kështu të përshpejtojnë procesin e integritimit në BE. Megjithatë, raportet ekzistuese kërkimore mbi bashkëpunimin ndërmjet aktorëve institucional dhe OSHC-ve në Kosovë, theksojnë se ky bashkëpunim mbetet ad-hoc; dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në

²² Intervistë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Prishtinë, 6 shtator 2016.

²³ Intervistë në GIZ Kosovë, Prishtinë, 19 korrik 2016.

hartimin e politikave publike/strategjive dhe në aktivitetet e monitorimit të aktorëve institucional është mjaft i pakënaqshëm.²⁴

2.4 Mekanizmat e Bashkëpunimit ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Akterëve Qeveritarë

Aktualisht, ka disa mekanizma që rregullojnë bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe Qeverisë së Kosovës në çështjet e procesit të integritimit Evropian. Një nga mekanizmat më të rëndësishëm është Këshilli Kombëtar për Integritime Evropiane. Ky këshill është themeluar në vitin 2012 nga ish-presidentja e Kosovës znj. Atifete Jahjaga. Këshilli Kombëtar për Integritime Evropiane funksiononte si një mekanizëm konsultativ dhe koordinues në mes të akterëve të ndryshëm për vendosjen e politikave kombëtare në procesin e integritimit Evropian. Ky mekanizëm, megjithatë, nuk është më funksional që nga zgjedhja e presidentit të ri të Kosovës.²⁵

Komisioni Parlamentar për Integritime Evropiane është një tjetër mekanizëm që monitoron procesin e harmonizimit të sistemit ligjor të Kosovës me sistemin ligjor të Bashkimit Evropian. Ndër të tjera, ky komision fton OSHC-të të marrin pjesë në mbledhjet e hapura, ku ata kanë mundësinë për të mbikëqyrur punën e këtij komisioni në lidhje me përafrimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së. Për më tepër, komisioni ka nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi me disa OSHC-të specializuara dhe disa prej tyre tashmë janë kontraktuar për të ofruar ekspertizën e tyre për komisionin.²⁶

Përfaqësuesit qeveritarë të intervistuar për këtë studim kanë argumentuar se nuk ekziston nevoja për krijim të mekanizmave shtesë të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe Qeverisë së Kosovës në çështje të integritimit Evropian. Qeveria e Kosovës shfrytëzon mekanizmat

²⁴ Curri, F., Milutinović, B., Nesović, B. dhe Osmani, N. (2014) *Kosovë*. In: Zornaczuk, T. (Eds) *Shoqëria Civile e Ballkanit Perëndimor në Integritime të BE-së*, Varshavë: Polski Instytut Spraw Międzynarodowych.

²⁵ Intervistë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, 21 korrik 2016.

²⁶ Për më shumë funksione rreth Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane, vizitoni: <http://www.mei-ks.net/en/parliamentary-committee-for-european-integration> (vizituar me 13/09/2016).

ekzistues dhe praktikisht bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe OSHC-ve është i strukturuar në dy mënyra.

Së pari, OSHC-të konsultohen nga Qeveria e Kosovës gjatë përgaditjes së të gjitha akteve normative.

Së dyti, çdo vit OSHC-të konsultohen në përcaktim të prioriteteve sektoriale ose projekteve specifike në lidhje me mbështetjen financiare që BE-ja i ofron Kosovës. Mbështetja financiare nga BE-ja ofrohet nëpërmjet Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimin (IPA) me qëllim të mbështetjes së Kosovës në përafrim të institucioneve dhe ekonomisë me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian.²⁷

Me qëllim të ndërtimit të një partneriteti afat-gjatë dhe koordinimit për përkushtim të OSHC-ve, Qeveria e Kosovës më 2007 për herë të parë nënshkroi Momerandumin e Bashkëpunimit me OSHC-të (përfaqësuar nga platforma CiviKos). Platforma CiviKos është një iniciativë e OSHC-ve për të krijuar një ambient të përshtatshëm dhe formal të partneritetit ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë. Më 2013, si mënyrë për të forcuar dhe kanalizuar bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve (përfaqësuar nga platforma CiviKos) dhe qeverisë së Kosovës, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë ka zhvilluar Strategjinë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017. Kjo strategji përmban katër objektiva:

1. Të siguroj pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave zbatuese/legjislacionit;
2. Sistemin e kontraktimit të shërbimeve publike me organizatat e shoqërisë civile;
3. Të ndërtoj një sistem dhe definoj kriteret për përkrahje financiare të OSHC-ve; dhe
4. Promovoj një qasje integruese në zhvillim të vullnetarizmit.

Kjo strategji është efektive për pesë vjet në periudhën kohore 2013-2017. Me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin e rekomandimeve politike dhe legjislacionit, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Rregulloret për Procedurë të Qeverisë së Kosovës (Vendimi nr. 04/34). Bazuar në këtë rregullore, Qeveria e Kosovës kërkon nga të gjitha institucionet vartëse të publikojnë përmbajtjet e propozimeve për komente publike

²⁷ Intervistë në Ministrinë e Integriteteve Evropiane (MIE), Prishtinë, 2 gusht 2016.

për të gjitha politikat dhe ligjet dhe në mënyrë specifike duhet të kërkoj komente nga organizatat jo-qeveritare që mund të ndikohen nga propozimi.²⁸

Edhe pse korniza ligjore ka ndikuar në përmirësim të iniciativave për bashkëpunim në hartim të politikave dhe ligjeve, zbatimi i suksesshëm i këtyre rregulloreve ka ngecur. Për shembull, më 2015 nga 80 ligje të hartuara dhe të aprovuara nga Qeveria, vetëm 21 ligje janë dërguar për konsultim publik në platformën e CiviKos.²⁹ Në anën tjetër, ka pasur pjesëmarrje të ulët të OSHC-ve në sesionet e konsultimeve publike. Pjesëmarrja e ulët mund të ketë qenë për arsye të mungesës së ekspertizës ose burimeve njerëzore, mungesës së informatave se si të jepet kontributi dhe mungesës së përfshirjes të komenteve të OSHC-ve në verzionet finale të dokumenteve.³⁰ Këto arsye janë vërtetuar edhe nga një studim që thekson se OSHC-të në Kosovë krahasuar me ato në rajon kanë më pak njohuri sa i përket strukturave ekzistuese dhe mekanizmave për dialog dhe bashkëpunim me institucionet lokale dhe qendrore.³¹

Me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë në procese të konsultimit publik, Momerandumi i Bashkëpunimit (19/07/2016) ndërmjet Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtave të Njeriut, Mundësive të Barabarta dhe Çështjeve Gjinore brenda zyrës së kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) është nënshkruar. Qëllimi i këtij momerandumi ka të bëjë me pajtimin ndërmjet dy palëve në dizajnimin dhe zbatimin e programeve për ndërtim të kapaciteteve për shërbyesit civil gjatë procesit të konsultimit publik. Programet për ndërtim të kapaciteteve kanë për qëllim që të përmirësojnë aftësitë e shërbyesve publik për të vepruar si pikë kontaktuese me OSHC-të. Si rezultat, ky program do të ndihmon në bashkëpunim më të madh të dokumenteve legislative, ndarjen e dokumenteve në faza të mëhershme të formulimit dhe përfshirje më të madhe të komenteve të OSHC-ve në dokumente të lëshuara për konsultim publik nga qeveria.

²⁸ Shih fusnotën 14.

²⁹ Kryeziu, D. (2016) *Konsultimi Publik me Organizatat Anëtare të CiviKos gjatë vitit 2015*. E disponueshme: http://www.civikos.net/repository/docs/Raport_Permbledhes-Konsultimi_public_247855.pdf (vizituar më: 13/09/2016).

³⁰ Intervistë në GIZ Kosovë, Prishtinë, 19 korrik 2016.

³¹ Instituti Ndërkombëtarë Suedez për administratë publike (2014) *Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë*. E disponueshme: http://www.tacso.org/doc/ipsos_report_ko.pdf (vizituar më: 13/09/2016).

Si përmbledhje, ekzistojnë disa mekanizma për të orientuar bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë. Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me OSHC-të (përfaqësuar nga platforma CiviKos) ka zhvilluar Strategjinë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017. Edhe pse ky bashkëpunim bazohet në disa mekanizma, kjo duhet të jetësohet në terma praktikë. Për shembull, çështjet e përshkruara më sipër ndërlidhur me proceset e konsultimit publik ndërmjet dy palëve duhet të adresohen.

2.5 Cilësia e Bashkëpunimit ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Kombëtare në Kosovë

Një numër i madh i të intervistuarve për këtë studim theksojnë që cilësia e bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve qeveritare nuk është në nivelin e duhur.³² Kur theksohet cilësia e bashkëpunimit, të intervistuarit përqendrohen te sfidat në lidhje me disa aktivitete. Duhet të theksohet se këto sfida nuk janë unike për kontekstin e Kosovës. Me sfida të ngjashme janë ballafaquar edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.³³

Ky seksion i përmbledh sfidat në katër kategori: (1) sesionet për konsultim publik mbi hartimin e dokumenteve/strategjive; (2) aktivitetet për ngritje të vetëdijes në lidhje me MSA-në dhe proceset e integritimit në BE; (3) monitorimi i zbatimit të MSA-së dhe proceseve integruese në BE; dhe (4) sfidat tjera në lidhje me sektorin e shoqërisë civile.

I. Sesionet për konsultim publik për hartim të dokumenteve/strategjive mbi proceset integruese të BE-së është një nga aktivitetet kyçe që kërkon bashkëpunim ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe OSHC-ve. Sipas gjetjeve të këtij studimi ekzistojnë disa pengesa që ndikojnë negativisht në cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe OSHC-ve. *Së pari*, të dhënat tregojnë për mungesë transparence dhe bashkëpunimi me OSHC-të. Në këtë kontekst, qeveria rrallë herë organizon sesione të konsultimit publik për hartim të dokumenteve/strategjive. *Së dyti*, edhe kur

³² Intervistë në Levizja FOL, Prishtinë, 24 gusht 2016; Intervistë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, 21 korrik 2016.

³³ Shih Żornaczuk, T. (2014) *Shoqëria Civile e Ballkanit Perëndimor në Integritime të BE-së*, Varshavë: Polski Instytut Spraw Międzynarodowych.

organizohen sesionet konsultuese, afatet për dhënie të komenteve në dokumente/strategji janë të shkurta. Si e tillë, OSHC-të shpeshherë nuk mund të japin kontribut substancial në dokumente. Ndonjëherë, pengesë tjetër është, edhe kur komentet ofrohen nga OSHC-të, përfaqësuesit qeveritarë nuk i përfshijnë këto komente në verzionet përfundimtare të dokumentit. Prandaj, me qëllim të ngritjes së cilësisë së bashkëpunimit, do të ishte në përfitim të qeverisë që të organizon sesione konsultimi me OSHC-të. Për më shumë, me qëllim të ngritjes së transparencës dhe bashkëpunimit me OSHC-të, do të ishte në interes të qeverisë që t'i ndaj dokumentet/strategjitë me kohë dhe t'i përfshijë komentet në verzionet finale të dokumentit. Poashtu, do të ishte në interes të qeverisë që OSHC-ve t'i tregoj arsyet e mos-përfshirjes së komenteve në verzionet finale të dokumentit/strategjisë.

II. Aktivitetet për ngritje të vetëdijes mbi marrëveshjen për MSA-në dhe proceset e integruese në BE është një fushë tjetër që kërkon bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë. Një nga pengesat kyçe që ndikon në cilësinë e bashkëpunimit është mungesa e ndarjes së informatave për procesin e MSA-së nga përfaqësuesit qeveritarë me aktorët kryesorë dhe të tjerë të përfshirë drejtëpërdrejtë në proceset integruese.³⁴ Disa OSHC nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave të ndryshme kanë punuar në ngritje të vetëdijes në lidhje me proceset integruese në BE dhe përmbajtje të MSA-së. Në anën tjetër, përfaqësuesit qeveritarë të intervistuar për këtë studim theksojnë se OSHC-të mund të jenë edhe më efikase në përhapje të informatave për publikun e gjerë. Në përgjithësi, theksohet se kjo detyrë mund t'ju delegohet OSHC-ve.³⁵ Prandaj, me qëllim të ngritjes së cilësisë së bashkëpunimit është e nevojshme që aktorët qeveritarë të ftojnë dhe angazhojnë OSHC-të në zhvillim të fushatave për “ngritje të vetëdijes”.

Organizimi i fushatave për “ngritje të vetëdijes” dhe diskutimeve publike në lidhje me proceset integruese në BE mund të rrisë gatishmërinë e opinionit publik në lidhje me agjendën reformuese. Në përgjithësi besohet se ekziston mungesë e vetëdijes nga

³⁴ Intervistë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), Prishtinë, 6 Shtator 2016.

³⁵ Intervistë në Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE), Prishtinë, 18 korrik 2016.

ana e qytetarëve në lidhje me përmbajtjen e MSA-së. Për shembull, është e rëndësishme që komuniteti i biznesit të kuptoj një pjesë të përmbajtjes pasi që kjo do të ketë pasoja direkte në punën dhe aftësinë e tyre për të konkurruar në tregun Evropian. Komuniteti i biznesit duhet të zbatoj standarde të reja në aspektin e cilësisë së produktit.³⁶ Ose, fermerët duhet t’ju përshtaten rregulloreve të ndryshme Evropiane të cilat do të ndikojnë në punën e tyre të përditshme.³⁷ Për këto arsye, është e rëndësishme që të organizohen fushata ose diskutime publike me qëllim të “ngritjes së vetëdijës” për përmbajtjen e MSA-së, ashtu që komunitetet specifike të kuptojnë dhe të përgaditen për ndryshimet vijuese.³⁸ Në përgjithësi, qytetarët duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për proceset integruese në BE dhe të jenë të vullnetshëm për të luajtur rol aktiv në shtytjen e agjendës reformuese që është e nevojshme për zbatim të MSA-së.

III. Monitorimi i zbatimit të marrëveshjes së MSA-në dhe performanca e aktorëve qeveritarë drejt proceseve integruese të BE-së, është një fushë tjetër që kërkon bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë. Monitorimi i zbatimit të reformave të kërkuara nga BE-ja konsiderohet një nga aktivitetet kyçe të OSHC-ve drejt proceseve integruese në BE. Deri më tani, vetëm disa OSHC ushtrojnë këtë rol, dhe kjo është e kufizuar vetëm në disa aspekte të MSA-së. Megjithatë, këto OSHC kanë kontribuar në ngritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së autoriteteve publike në disa fusha të caktuara, sikurse të sistemit juridik³⁹ dhe të drejtat e minoriteteve. Kjo, poashtu, lejon që OSHC-të të zgjerojnë rolin dhe aktivitetet e tyre në fusha të tjerë të MSA-së.

Me qëllim të përcaktimit të një partneriteti të shëndetshëm dhe cilësorë ndërmjet qeverisë dhe OSHC-ve në procesin e integritimeve Evropiane, është e rëndësishme që të ndahet përgjegjësia në politik-bërje dhe zbatim të saj, ngritje të vetëdijes dhe monitorim të zbatimit

³⁶ Intervistë në CiviKos, Prishtinë, 25 korrik 2016.

³⁷ Intervistë në Ministrinë e Integritimeve Evropiane (MIE), Prishtinë, 18 korrik 2016.

³⁸ Intervistë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, 21 korrik 2016.

³⁹ Dreisbach, T. (2014) *Njëri sy në drejtësi: monitorimi i gjykatave Kosovare, 2008–2014*. E disponueshme: https://successfulsocieties.princeton.edu/sites/successfulsocieties/files/TD_CitizenMonitoring_Kosovo.pdf (vizituar më: 13/09/2016).

të MSA-së. Poashtu, është e rëndësishme që të reflektohet dhe të ballafaqohet me ***sfidat tjera*** që ndikojnë në cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë. Këto janë katër sfida të cilat janë përmbledhur në kategorinë (***sfidat tjera***), dhe që kanë të bëjnë vetëm me sektorin e OSHC-ve.

IV. Stabiliteti financiar është një nga sfidat kryesore që pengon rolin e OSHC-ve drejt procesit të integritimit Evropian. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, OSHC-të detyrohen t'i përshtasin prioritetet e tyre dhe objektivat e organizatës në bazë të kërkesave të organizatave donatore.⁴⁰ Poashtu, grantet qeveritare janë të kufizuara dhe nuk shpërndahen bazuar në kritere të qarta të meritës.⁴¹ Për shkak të kufizimeve në fonde, shpeshherë OSHC-të nuk mund të caktojnë punëtorë të cilët i ndjekin nga afër dhe përditësohen me zhvillimet e kryesore nga proceset e integritimit Evropian (nga Ministria për Integritim Evropian në Kosovë ose zyra të caktuara të Komisionit Evropian).⁴² Si e tillë, zhvillime të rëndësishme në lidhje me proceset integruese në BE nuk mund të absorbohen dhe reflektohen. Prandaj, sigurimi i mjeteve të mjaftueshme financiare për projekte afat-gjata mund të lehtëson dhe ndihmon në tejkalimin e kësaj sfide. Gjithashtu, stabiliteti financiar mund të forcon rolin e OSHC-ve dhe rris cilësinë e bashkëpunimit me aktorët qeveritarë.

IV.1. Profilizimi i OSHC-ve ose specializimi i tyre në sektore specifike është një sfidë tjetër e ndërlidhur ngushtë me sfidën e sipër-përmendur. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se vetëm disa OSHC janë të specializuara në sektorë specifikë në lidhje me proceset integruese në BE dhe janë të përqendruara në arritjen e objektivave të tyre.⁴³ Puna e OSHC-ve drejt proceseve integruese në BE përqendrohet më shumë në sektore, si të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit, dhe më pak në sektore tjera, si

⁴⁰ Intervistë në GIZ Kosovë, Prishtinë, 19 korrik 2016; Intervistë në D4D, Prishtinë, 3 gusht 2016.

⁴¹ Intervistë në GIZ Kosovë, Prishtinë, 19 korrik 2016.

⁴² Intervistë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, 21 korrik 2016.

⁴³ Intervistë në GIZ Kosovë, Prishtinë, 19 korrik 2016; Intervistë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, 21 korrik 2016.

mbrojtja e ambientit dhe ekonomia.⁴⁴ Për shkak të mungesës së profilizimit, OSHC-të në Kosovë shpeshherë ndërrojnë rolet duke u përqendruar në sektore të ndryshme. Si rezultat, ata nuk janë në gjendje të krijojnë partneritet kredibil dhe afat-gjatë me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare. Me qëllim të tejkalimit të kësaj pengese, OSHC-të mund të përfitojnë duke u përqendruar në sektore më pak të njohura të BE-së në Kosovë, sikurse mbrojtja e ambientit, ekonomia, etj.

IV.2. Ndërtimi i kapaciteteve në shoqërinë civile është një sfidë tjetër e identifikuar gjatë procesit intervistues. Për shembull, një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve ende janë të painformuar rreth mekanizmave bashkëpunues me akterët qeveritarë në zbatim të MSA-së – sikurse shfrytëzimi i mundësive për të marrë pjesë në konsultime publike.⁴⁵ Me qëllim të zhvillimit të burimeve njerëzore, stafi i OSHC-ve duhet të trajnohet në fusha specifike, si formimi i projekt propozimeve specifike, shkathtësi të politik-bërjes, shkathtësi kërkuese, shkathtësi negociuese dhe ofrim të feedback-ut gjatë konsultimeve publike me akterët qeveritarë.⁴⁶

IV.3. Rrjetëzimi ndërmjet OSHC-ve në Kosovë është një sfidë tjetër e theksuar nga pjesëmarrësit në studim. Aktualisht, CiviKos është një format më i njohur për OSHC-të në Kosovë ku mund të mblidhen dhe ndërveprojnë. Kjo shërben si platformë bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë. Sidoqoftë, është e rëndësishme që rrjeti aktual të zgjerohet dhe përfshij OSHC tjera.⁴⁷ Përveç zgjerimit të rrjetës, OSHC-të duhet të jenë më efektive. Nëpërmjet zgjerimit, OSHC-të mund të organizojnë aktivitete të përbashkëta (p.sh. hulumtim) që do të rezultojnë në një kontribut më të vlefshëm drejt proceseve integruese në BE.⁴⁸

⁴⁴ Intervistë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, 21 korrik 2016; Intervistë në CiviKos, Prishtinë, 25 korrik 2016; Intervistë at the Ministry of European Integration (MIE), Pristina, 2 August 2016.

⁴⁵ Intervistë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), Prishtinë, 6 Shtator 2016.

⁴⁶ Intervistë në Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE), Prishtinë, 2 gusht 2016.

⁴⁷ Intervistë në Balkans Group, Prishtinë, 29 korrik 2016.

⁴⁸ Intervistë në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim, Kosovë – BE, Prishtinë, 16 gusht 2016.

3. Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile në Proceset e Integritimit Evropian në Ballkanin Perëndimor: Mësimet nga Kroacia

Mund të jetë e dobishme që të eksplorohej përvojat nga bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe OSHC-ve në vende tjera që janë integruar së fundmi në Bashkimin Evropian, me qëllim që OSHC-të në Kosovë të përfitojnë nga përvojat pozitive të rolit të OSHC-ve dhe përfshirjes së tyre në procesin e integritimit Evropian. Për këtë qëllim, do të analizohet përfshirja e OSHC-ve në proceset integruese Evropiane në rastin e Kroacisë.

Zyrtarisht negociatat ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kroacisë kanë filluar në tetor 2005. Republika e Kroacisë zyrtarisht është bërë pjesë e BE-së më 1 korrik 2013. Procesi i integritimit në BE në tërësi ka zgjatur rreth një dekadë. Gjatë këtij procesi, Republika e Kroacisë ka hartuar tri dokumente kyçe që kanë udhëzuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe sektorit të shoqërisë civile. Këto dokumente shkurtimisht janë paraqitur më poshtë:

- ❖ Strategjia Kombëtare për Krijim të një Ambienti të Përshtatshëm për Zhvillim të Shoqërisë Civile 2012-2016. Kjo strategji ka shërbyer si udhëzues për përmirësim të sistemit ligjor, financiar dhe institucional për OSHC-të si faktorë të rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kroacisë, si dhe për palët tjera të interesuara në zbatim të politikave të BE-së.
- ❖ Kodi i Praktikave të Mira dhe Standardeve për Financim të Programeve të Organizatave të Shoqërisë Civile jashtë Shtetit dhe Buxhetit Vendor (2007). Ky dokument ka rregulluar standardet dhe parimet e praktikës së organeve administrative dhe zyreve në procedim të dhënies së granteve nga buxheti Shtetërorë për OSHC-të me qëllim të zbatimit të programeve dhe projekteve që janë në interes të të mirës së përgjithshme në Republikën e Kroacisë.
- ❖ Kodi i Praktikës për Konsultim me Palët e Interesuara në Procedurat e Adaptimit të Ligjeve, Rregulloreve dhe Akteve tjera (2009). Ky dokument ka ofruar udhëzimet për

konsultim efikas nga organet shtetërore dhe palët e interesuara në procedurat e adaptimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera, si dhe praktikat ekzistuese për konsultime në disa administrata shtetërore.

Qeveria e Kroacisë gjatë procesit negociues ka themeluar grupe punuese në bazë të kapitujve negociues. Shumë grupe punuese përbëhen nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, organizatave, përfaqësues të biznesit dhe sindikatave të punëtorëve, etj. Rreth 1,500 njerëz janë përfshirë në aktivitetet e 35 grupeve punuese në Republikën e Kroacisë.⁴⁹

Megjithatë, përfshirja e zgjeruar e OSHC-ve nuk është respektuar në mënyrë të barabartë në grupe të ndryshme punuese. Për shembull, grupet punuese 23 dhe 24 që janë marrur me çështjet e të drejtave të njeriut, kthimin e refugjatëve, krimet e luftës dhe korrupsionin fillimisht janë përbërë vetëm nga përfaqësues nga qeveria dhe gjyqësori. Duke vërejtur që përfaqësues të organizatave të ndryshme dhe ekspertë me njohuri profesionale janë përjashtuar nga këto çështje, OSHC-të në Kroaci formuan një koalicion ad-hoc të OJQ-ve për monitorim të negociatave të kapitullit 23. Qëllimi parësor i këtij koalicioni ishte publikimi i raporteve të monitorimit mbi negociatat dhe krijimi i një liste të kërkesave për Qeverinë e Kroacisë dhe Brukselin që duhej të ishin pjesë e kapitullit 23. Në esencë, çfarë filloi si një koalicion ad-hoc, shumë shpejt u transformua në Platformën 112 – themeluar nga 69 OSHC për të punuar në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të njeriut dhe sundim të ligjit. Si rezultat i aktiviteteve të avokimit ndaj Qeverisë së Kroacisë dhe Brukselit, Platforma 112 arriti që të zgjeroj kapitullin 23 duke përfshirë çështje të reja të cilat u inkuadruan pas përfshirjes aktive të Platformës 112. Arsyeja kryesore e suksesit të tillë iu është atribuar krijimit të rrjetit dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet OSHC-ve.⁵⁰

Në anën tjetër, Ministria e Zhvillimit Rajonal në Republikën e Kroacisë shërben si një shembull i mirë ilustrues në përfshirjen e OSHC-ve. Gjatë procesit të anëtarësimit në BE,

⁴⁹ Đokić, I. dhe Sumpor, M. (2013) *Roli i Organizatave Kroate të Shoqërisë Civile në Procesin e Anëtarësimit të Bashkimit Evropian*. E disponueshme:

<http://www.tacso.org/doc/Role%20of%20Croatian%20CSOs%20in%20EU%20Accession%20process-final.pdf>
(vizituar më: 13/09/2016).

⁵⁰ Po aty.

Ministria e Zhvillimit Rajonal ishte përgjegjëse në hartimin e dokumenteve strategjike të BE-së. Me qëllim të hartimit të dokumenteve strategjike, Ministria formoi grupe tematike të përbëra nga përfaqësues të ministrive dhe institucioneve tjera. Të gjitha grupet punuese të koordinuara nga ministria respektive kanë përfshirë përfaqësues të OSHC-ve. Bashkëpunimi ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë civile ishte përmendur edhe në raportin e progresit të Komisionit Evropian (2012) si praktikë e mirë e cila duhet të shtrihet edhe në fusha tjera.⁵¹

Roli aktiv i OSHC-ve në Republikën e Kroacisë gjatë procesit të anëtarësimit në BE ishte raportuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian.⁵² Megjithatë, në një raport të detajuar, Škrabalo (2012) ka paraqitur një numër të pengesave me të cilat janë ballafaquar OSHC-të në Kroaci gjatë procesit të anëtarësimit në BE.⁵³ Tri sfida të cilat mund të jenë relevante për kontekstin e Kosovës janë paraqitur më poshtë:

- ❖ Mungesa e transparencës gjatë procesit negociues nga ana e Komisionit Evropian dhe Qeverisë Kroate. Si rezultat, OSHC-të nuk kanë mundur të ofrojnë kontribut substancial gjatë procesit negociues.
- ❖ Transparenca sa i përket informatave mbi procesin negociues nuk ishte ofruar për opinionin publik. Por, pas disa viteve të presionit nga OSHC-të, Qeveria e Republikës së Kroacisë filloj të publikoj disa dokumente të cilat diskutoheshin gjatë procesit negociues. Platforma 112 është shembull tipikë që ilustron efektet pozitive pas presionit të ushtruar në Qeverinë Kroate.
- ❖ Një pengesë tjetër e OSHC-ve lidhet me urgjencën dhe vëllimin e përshtatjeve legislative me *acquis*. Përshkak të mbingarkesës dhe urgjencës së përshtatjes së

⁵¹ Po aty.

⁵² Komisioni Evropian (2011) *Kroacia 2011 Raporti i Progresit*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/hr_rapport_2011_en.pdf (vizituar më: 13/09/2016).

⁵³ Škrabalo, M. (2012) *Transparenca në retrospekt: mësimet preliminare nga procesi i anëtarësimit të Kroacisë në BE*. E disponueshme: <http://www.franziska-brantner.eu/ep-content/uploads/2012/11/Transparency-in-retrospect.pdf> (vizituar më: 13/09/2016).

rregulloreve, OSHC-të shpeshherë nuk ishin në gjendje të japin kontribut substancial në formim të politikave. Si shembull ilustrues, Škrabalo përmend se gjatë procesit negociues në periudhën 2007-2011, 87% e ligjeve kanë kaluar me procedura urgjente.

Duke pasur parasysh pengesat e ballafaquara nga OSHC-të në Republikën e Kroacisë gjatë procesit të anëtarësimit në BE, studime të ndryshme kanë raportuar një numër të rekomandimeve për forcimin dhe zgjerimin e rolit të OSHC-së. Rekomandimet vijuese për OSHC-të në Kroaci të paraqitura më poshtë janë raportuar nga një studimi kredibil.⁵⁴ Këto rekomandime duket të jenë relevante për kontekstin e Kosovës.

- ❖ Të identifikohen mënyra të reja të ushtrimit të presionit ndaj organieve qeveritare, si për shembull monitorimi dhe raportimi i rregullt i punës së qeverisë për procesin e anëtarësimit në BE. Përditësimi me informata i publikut vendor dhe ndërkombëtar për çdo ndryshim pozitiv ose negativ gjatë procesit të negociimit me BE-në;
- ❖ Krijimi i ndryshimeve të nevojshme brenda organizatës sikurse profilizimi në fusha specifike ose tematike. Kjo është e domosdoshme nëse OSHC-të dëshirojnë të njihen si organizatë kredibile nga opinioni publik dhe institucionet qeveritare;
- ❖ Investimi në bashkëpunim dhe krijim të partneritetit me OSHC tjera, institucione lokale dhe qendrore. Shembulli i Platformës 112 ilustron përparësitë e krijimit të një rrjeti të OSHC-ve dhe efektet pozitive që rezultojnë nga presioni i ushtruar ndaj qeverisë; dhe
- ❖ Zhvillimi i kapaciteteve në avokim të politikave publike, analizë dhe raportim.

Duhet të theksohet se përvoja nga rasti i Kroacisë ilustron se si OSHC-të nëpërmjet rrjetëzimit dhe aktiviteteve avokuese shëndrrohen në aktorë të rëndësishëm dhe orientues

⁵⁴ Shih fusnotën 49.

të opinionit publik gjatë procesit të anëtarësimit në BE. Për më shumë, procesi i anëtarësimit në BE ka forcuar dukshëm pozitën e OSHC-ve në raport me institucionet shtetërore. Përkundër sfidave me të cilat janë ballafaquar OSHC-të, ky proces ka rezultuar në krijim të partneritetit ndërmjet OSHC-ve të ndryshme (p.sh., krijuar besim të dyanshëm), por dhe ka përmirësuar raportet ndërmjet OSHC-ve dhe aktorëve qeveritarë.⁵⁵ Përfundimisht, rasti i Kroacisë tregon nevojën për angazhim me kohë në proces të anëtarësimit në BE të të gjithë aktorëve relevant.

Për të përmbledhur shkurtimisht, bazuar në përvojën e OSHC-ve në Republikën e Kroacisë, OSHC-të në Kosovë duhet të **(i)** krijojnë rrjet efektiv që do të shërbente si platform koordinuese e aktiviteteve të OSHC-ve. OSHC-të në Kosovë duhet të **(ii)** organizojnë aktivitete monitoruese dhe të ndjekin për së afërmi marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe BE-së, si dhe zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Në rast të mos-transparencës sa i përket marrëveshjeve, rasti i Kroacisë tregon se **(iii)** aktivitetet avokuese dhe lobuese të OSHC-ve duhet të orientohen si ndaj aktorëve qeveritarë ashtu edhe ndaj atyre të BE-së.

4. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Rruga e Kosovës drejt procesit të integrimeve Evropiane është një proces i komplikuar në të cilën vlerat, normat dhe politikat e BE-së shpërndahen brenda Kosovës, derisa MSA-ja është instrumenti i parë që ka për qëllim reformimin dhe funksionimin politik dhe ekonomik të Kosovës. Një nga elementet kryesore të procesit integruar të BE-së është kërkesa për zhvillim të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe akterëve qeveritarë. Në demokracinë moderne, bashkëpunimi i mirë ndërmjet OSHC-ve dhe akterëve qeveritarë ndikon pozitivisht në lirinë qytetare, zvogëlim të korrupsionit shtetëror dhe zhvillim të një qeverisje më efikase.⁵⁶

Përkundër zhvillimit, OSHC-të në Kosovë mbesin pjesërisht të integruara në zbatim të MSA-së dhe proceseve integruese në BE. Në këtë fazë, qeveria ka ofruar një bazë të mirë për

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Boštic, V. A. (2011) Analizë e BE-së për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Bosne dhe Hercegovinë *Revista mbi Perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor*, Vëll. 3 Nr. 4, ff 91-113.

bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të strukturuar me OSHC-të në disa fusha, sikurse analiza të politikave dhe avokim, monitorim të implementimit të MSA-së dhe në ngritje të vetëdijes për proceset integruese në BE dhe MSA-së. Megjithatë, krijimi i mekanizmave për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe akterëve qeveritarë nuk nënkupton edhe një ndërveprim cilësorë – derisa nuk ekziston një kulturë bashkëpunuese nga të dyja anët.⁵⁷ Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit, është e nevojshme që OSHC-të të angazhohen më shumë në proceset e integritimit Evropian, duke qenë më transparent dhe të hapur për dialog. Një komponentë tjetër e rëndësishme është mbajtja e një stabiliteti në raporte, me qëllim që organizatat e shoqërisë civile të luajnë një rol më të plotë dhe proaktiv në proceset integruese. OSHC-të duhet të punojnë në zgjerimin e ekspertizës në disa fusha të ndërlidhura me proceset integruese në BE ashtu që të mund të luajnë një rol më aktivë gjatë konsultimeve publike ose monitorim të performancës së organeve shtetërore. Për më shumë, OSHC-të duhet të shfrytëzojnë procesin e anëtarësimit si një platformë për zhvillim të partneritetit dhe krijim të raporteve më afat-gjate me qeverinë. Ky proces është i rëndësishëm së veçantë pasi që një bashkëpunim produktiv mund të përshpejtojë agjendën e reformave në Kosovë drejt proceseve integruese të BE-së.⁵⁸

Prandaj, bazuar në intervistat e zhvilluara më akterët relevantë në këtë studim dhe përvojën e OSHC-ve nga Kroacia, ky raport paraqet rekomandimet në dy kategori të ndërlidhura: (i) kategoria e parë e rekomandimeve ka të bëjë me institucionet e Kosovës (kryesisht Qeverinë e Kosovës); dhe (ii) kategoria e dytë ka të bëjë me OSHC-të, në mënyrë që të zgjerojnë rolin e tyre drejt proceseve integruese të BE-së. Në seksionin vijues, elaborohen rekomandimet për OSHC-të dhe Qeverinë e Kosovës (në veçanti për Ministrinë e Integritimit Evropian) duke u fokusuar në proceset integruese të BE-së.

⁵⁷ Shih fusnotën 21.

⁵⁸ Elek, B., Ubović, L. dhe Žornacuk, T. (2015) *Rrjetet e Shoqërisë Civile për Integritetin e Serbisë në BE*. Punim politikë, 8 (110), 1-7. E disponueshme: https://www.pism.pl/files/?id_plik=19609 (vizituar më: 13/09/2016).

4.1. Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës

Me qëllim të forcimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit me OSHC-të, rekomandimet vijuese mund të jenë të dobishme për Qeverinë e Kosovës:

- ❖ Të punohet në krijimin e marrëdhënieve më të mira me OSHC-të. Më konkretisht, të zbatohet në tërësi Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017. Në këtë aspekt, do të ishte e rekomandueshme të trajnohet një numër të stafit në rolin dhe rëndësinë e shoqërisë civile drejt proceseve integruese në BE;
- ❖ Të krijohet një përfshirje pro-aktive të OSHC-ve në proceset vendim-marrëse në lidhje me integrimet Evropiane. Veçanërisht, përfshini OSHC-të në zhvillim dhe harmonizim të dokumenteve strategjike, si plane kombëtare të zhvillimit;
- ❖ Të organizohen takime konsultuese me grupe të OSHC-ve, si shembull gjatë hartimit të ligjeve ose dokumenteve tjera strategjike për proceset integruese të Kosovës drejt BE-së. Ne theksojmë rëndësinë e përfshirjes domethënëse dhe me kohë të përfaqësuesve të OSHC-ve. Kjo do t'ju mundësonte që përfaqësuesit e OSHC-ve të ofrojnë komente dhe diskutojnë idetë e ndryshme në fazat e hershme të hartimit të dokumenteve legislative;
- ❖ Të ftohen më shumë OSHC në takimet e konsultimeve publike dhe të inkurajohen përfshirjen e tyre në zbatim dhe monitorim të MSA-së;
- ❖ Në ndërlidhje me rekomandimin paraprak, rrisni bashkëpunimin duke përfshirë më shumë OSHC, ashtu që të përfaqësohen interesat e komuniteteve të ndryshme. Mundësitë për përfshirje të OSHC-ve mund të promovohen nëpërmjet takimeve informuese, faqeve të internetit dhe mediave;
- ❖ Të rritet transparenca dhe përgjegjësia e institucioneve qeveritare duke publikuar me kohë dokumentet relevante, me qëllim që OSHC-të të mund të monitorojnë dhe

ofrojnë komentet e tyre. Për shembull, akterët qeveritarë mund të shfrytëzojnë platformën e CiviKos për të publikuar të gjitha dokumentet relevante dhe të kërkojnë komentet e OSHC-ve;

- ❖ Të angazhoheni në dialog aktivë me OSHC-të në çështje të konsultimeve publike. Më konkretisht, të tregohen arsyet e mos-përfshirjes së komenteve të ofruara nga përfaqësues të OSHC-ve në verzionet finale të dokumentit;
- ❖ Të krijohen masa efikase për mbrojtjen e të drejtës për qasje në informata për OSHC-të. Për shembull, mund të jetë i dobishëm hartimi dhe zbatimi i një programi trajnues për shërbyesit civil në politik-bërje dhe proceset e hartimit të ligjeve. Një mekanizëm tjetër është zbatimi i sanksioneve ligjore ndaj shërbyesve civil që refuzojnë ndarjen e informacioneve zyrtare;
- ❖ Të ofrohen dhe sigurohet shpërndarje të drejtë të mjeteve financiare dhe përkrahni projektet e OSHC-ve të cilat ndikojnë në agjendën reformuese, sikurse projektet në lidhje me ngritjen e vetëdijes për MSA-në. Në këtë aspekt, e rëndësishme është të përcaktohen kritere të qarta dhe relevante gjatë procesit të aplikimit për fonde. Për më shumë, krijoni një komitet të pavarur për të vlerësuar në mënyrë të drejtë aplikacionet nga OSHC-të dhe publikoni rezultatet përfundimtare;
- ❖ Të ofrohet mbështetje teknike OSHC-ve në zhvillimin e kompetencave të OSHC-ve për ofrim të shërbimeve (avokim, monitorim të performancës së qeverisë, ofrim të shërbimeve). E rëndësishme është të mbështeten OSHC-të në zbatim të projekteve që do të mbulonin sektore të MSA-së;
- ❖ Të krijohen kanale për informim të publikut (p.sh., bizneset ose opinionin publik) në çështje të MSA-së. Për shembull, të hapet një zyrë ose linjë telefonike ku qytetarët e interesuar mund të kërkojnë informacione relevante. Ose një mënyrë tjetër është duke ia deleguar këtë detyrë OSHC-ve.

4.2. Rekomandimet për Organizatat e Shoqërisë Civile

Me qëllim të zgjerimit të rolit të saj drejt proceseve integruese në BE dhe forcimit të cilësisë me Qeverinë e Kosovës, rekomandimet vijuese mund të jenë të dobishme për OSHC-të:

- ❖ Pjesëmarrja në takimet e konsultimit publik me institucionet qeveritare. Të ofrohen propozime konkrete dhe konstruktive për institucionet qeveritare në bërje të politikave ose procese tjera në lidhje me zbatimin e MSA-së. Pjesëmarrja në takimet e konsultimit publik do t'i bënte OSHC-të akterë më aktivë në monitorim të zbatimit të MSA-së;
- ❖ Të ofrohen komente/rekomandime në propozime të politikave/strategjive, edhe nëse nuk ftoheni për këtë. Kjo praktikë mund të zhvilloj besimin në OSHC dhe forcoj pozitën e OSHC-ve si aktorë të rëndësishëm në këtë proces;
- ❖ Të kërkohet transparencë dhe llogaridhënie nga akterët qeveritarë (lokal dhe qëndror). Një mënyrë për të bërë këtë është duke kërkuar qasje në dokumente relevante dhe pjesëmarrje në takime. Mënyra tjetër është duke publikuar raporte dhe duke kërkuar përgjegjësi nga akterët e caktuar që nuk kanë treguar progres drejt agjendës së BE-së;
- ❖ Të krijohen rrjete dhe bashkëpunim më aktiv me OSHC-të e profilit të ngjashëm. Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit do t'ju ndihmon që të shkëmbeni praktika, përvoja dhe koordinim të aktiviteteve me qëllim të lehtësimit të rrugës së Kosovës drejt BE-së;
- ❖ Të organizohen aktivitete për të monitoruar performancën e institucioneve të Kosovës. Monitorimi i aktiviteteve mund të ndikoj në cilësinë e raporteve dhe procesin negociues me BE-në, por edhe mund të përmirësoj komunikimin me akterët qeveritarë dhe rrisë transparencën e qeverisë;

- ❖ Të përcaktohen objektiva afat-gjatë dhe përqendrimi të jetë më shumë në kapitujt tematik ndërlidhur me procesin zbatues të MSA-së. Të zhvillohe kapacitetet e brendshme duke u trajnuar në fusha si formulimi i projekt-propozimeve specifike, shkathtësi të politik-bërjes, shkathtësi kërkimore, shkathtësi negociuese dhe ofrim të feedbackut gjatë konsultimeve publike me akterët qeveritarë;
- ❖ Të zhvillohet ekspertizë në fusha të caktuara, sikurse të drejtat e njeriut, politika të ambientit, drejtësi, etj. Duke zhvilluar ekspertizë, OSHC-të do të mund të bashkëpunonin në mënyrë më substanciale me qeverinë dhe asistojnë atë drejt proceseve të integritimit BE-së;
- ❖ Të përcillet me kujdes përvoja e vendeve fqinjë në proceset integruese në BE. Kjo do të mundësonte që OSHC-të të analizojnë më hollësisht dhe krahasojnë përvojat e qeverisë së Kosovës në procesin e anëtarësimit në BE; dhe
- ❖ Të organizohen ngjarje publike dhe debate për MSA-në dhe çështje të integritimit Evropian me grupe specifike. Këto aktivitete do të rrisnin pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset integruese të BE-së.

5. Shtojca

Pyetësi

Pyetjet për ju

Emri dhe Mbiemri: _____

Organizata: _____

Shoqëria Civile – gjendja aktuale

- Në përgjithësi, si e shihni rolin e shoqërisë civile në proceset integruese të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Në çfarë mënyrë shoqëria civile mund të marrë pjesë në procesin integrues të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Çfarë është intensiteti dhe cilësia e pjesëmarrjes së shoqërisë civile procesin integrues të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Cilat janë mekanizmat ekzistues nëpërmjet së cilës qeveria dhe shoqëria civile ndërveprojnë në procesin integrues të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Cilat janë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria civile të cilat kufizojnë rolin e saj në procesin integrues të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Çfarë mendoni se janë qëndrimet e publikut në lidhje me procesin integrues në BE? A e kuptojnë së çfarë përfshinë anëtarësimi në BE?

Shoqëria Civile – përmirësimi i rolit

- A është duke i shfrytëzuar shoqëria civile mundësitë e krijuara nga procesi integrues në BE?

- Çfarë mund të bëjë qeveria më shumë për të forcuar rolin e shoqërisë civile/qytetarëve në procesin integruar në BE/procesin e zbatimit të MSA-së? A ka ndonjë plan konkret?
- Çfarë mund të bëjë shoqëria civile më shumë për të forcuar rolin e saj në procesin integruar në BE/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Si mund të ndikojnë aktorët e BE-së në përfshirjen e shoqërisë civile në procesin integruar në BE?
- Si mund të luan qytetari rol aktiv në procesin integruar të BE-së? A është shoqëria civile një mundësi për publikun?

Shoqëria Civile – rekomandimet

- Cilat do të ishin tri rekomandimet kryesore për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të tejkalimit të sfidave dhe zgjerimit të rolit të saj në procesin integruar të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- Cilat do të ishin tri rekomandimet kryesore për qeverinë që të zgjeroj rolin e shoqërisë civile në procesin integruar të BE-së/procesin e zbatimit të MSA-së?
- A pajtoheni nëse ju citojmë/parafrazojmë në studimin e publikuar duke përfshirë emrin tuaj ose përkatësinë institucionale?